

REPUBLIKA SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT TIRANE  
Nr. \_\_\_\_\_ vendimit

17083

V E N D I M  
( PER RRAGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK )

Sot me date 27-II-1997 une gjyqtare e gjykates se rrethit Tirane  
M. Deeli mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesit: Petraq Mufali i biri i Jorgjit, datl. 1968, lindur e banues ne fshatin Hajdaran te Elbasanit dhe z. Andrea Shqau i biri i Agimit, datl. 1974, lindur e banues ne fshatin Mlize te rrethit te Elbasanit, per regjistrimin e tyre si person juridik dhe

K O N S T A T O V A

Se kerkesa e paraqitur nga kerkuesit Petraq Mufali dhe Andrea Shqau per regjistrimin e tyre si person juridik ne shoqerine me pergjegjesi te kufizuar(sh.p.k) me dy ortake dhe me administrator z. Petraq Mufali duke krijuar Shoqerine "MUFALI" sh.p.k dhe me objekt te veprimtarise se saj:  
"-Shfrytezimi dhe perpunimi i lendet drusore, prodhim dhe tregtim te elementeve prej druri, te mobiljeve, prodhim dhe tregetim me shumice dhe pakice te materialeve prej druri per ndertim. Prodhim dhe tregtim te drurit si lende djegese etj.-Tregetim i mallrave te ndryshem industriale dhe ushqimore, bujqesore dhe blektorale, i bimeve medicinale, lendeve te ndertimit, tregetim te prehrave kimike dhe kimikateve te ndryshme. Tregetim me shumice dhe pakice. Importi dhe eksporti".

P E R K E T O A R E S Y E

Ne baze te ligjit Nr.7512 date 10.8.1991, te ligjit 7638 date 19.11.1992 dhe te ligjit Nr.7667 date 18.1.1993

V E N D O S A

Rregjistrimin si person juridik te shoqrise "M U F A L I" sh.p.k shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me dy ortake dhe me objekt te veprimtarise se saj: "-Shfrytezimin dhe perpunimin e lendet drusore, prodhim dhe tregtim te elementeve prej druri, te mobiljeve, prodhim dhe tregtim me shumice dhe pakice te materialeve prej druri per ndertim. Prodhim dhe tregtim te drurit si lende djegese etj.-Tregetim i mallrave te ndryshem industriale dhe ushqimore, bujqesore dhe blektorale, i bimeve medicinale, lendeve te ndertimit. Tregetim me shumice dhe pakice. IMPORT dhe EKSPORT".

Shoqeria e ka qendren e saj ne fshatin Mlize te rrethit te Elbasanit

Shoqeria perbehet nga dy ortake dhe administrator i shoqrise eshte z. Petraq Mufali. Shoqeria ka nnje kapital themeltar prej 100.000 leke i formuar ne menyre te barbarte me nga 50 % nga secili nga ortaket.

Kohëzgjatja e veprimtarise se shoqrise eshte mbi 10 vjet.

Kunder ketij vendimi mund te bhetet ankim ne gjykaten e Apelit ne  
Tirane.

G J Y Q T A R E  
Marjana Deeli  
*M. Deeli*

REPUBLIKA SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT TIRANE  
Nr. 17083/1, Vendimit

**V E N D I M**  
I GJYQTARES SE VETME

Sot me date 24.01.2000, une, gjyqtar i Gjykates se rrethit Tirane M. Bedi, pasi mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Petraq Mufali i biri i Jorgjit, lindur me 1968 ne fshatin Hajdaraj te rrethit te Elbasanit dhe banues ne Hajdaraj te rrethit te Elbasanit, i cili me kerkoi depozitimin e Vendimit Nr.1 date 14.1.2000 te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise "MUFALI" sh.p.k.

**K O N S T A T O V A**

Se me Vendim te Gjykates se rrethit Tirane nr.17.083 date 27.II.1997 eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregetare "Mufali" sh.p.k me dy ortake Petraq Mufali dhe Andrea Shqau. Me Vendimin nr.1 date 14.1.2000 te asamblese se ortakeve eshte vendosur:

1. Kuotat prej 50% ne sh.p.k "MUFALI" te ortakut Andrea Shqau ti shiten ortakut tjeter Petraq Mufali.
2. Shoqeria "MUFALI" sh.p.k te mbetet me ortak te vetem dhe me administrator te vetem Petraq Mufali. Administrator i shoqerise mbetet Z.Petraq Mufali.
3. Shoqeria "Mufali" sh.p.k do te ruaje emerin themelues te saj Shoqeri me perjegjesi te kufizuar "Mufali" sh.p.k
4. Ky vendim i bashkengjitet statutit te shoqerise "Mufali" sh.p.k te miratuar nga gjykata kopetente.
5. Depozitimin prane regjistrat tregetar te ketij vendimi.  
Ne keto kushte ai kerkon depozitimin e tyre prane regjistrat tregetar. Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

## PER KETO ARESYE

Ne baze te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite  
tregetare" dhe atij nr.7667 date 28.01.1993 "Per regjistrin tregetar".

### V E N D O S A

Pranimin e kerkeses.

Depozitimini ne regjistrin tregetar te Vendimit te Asamblese se  
Ortakove nr.1 date 14.1.2000.

Te behen shenimet perkatese ne regjistrin tregetar.

Ndaj vendimit lejohet ankim.

G J Y Q T A R E

*Maryana Sekli*  
*Melusiq*

## **URDHER REGJISTRIMI**

**Me 1.**

14083 -

**2.a.....** Mafali - Sipole.

**b.....** Mlizë - Elbasan.

**c.....** Shkrepqeriu, perpuni,  
Lidhja e modelit tregtisë  
i dhimit, modeli i tregtisë  
tregtisë me 8.000.000 Lekë

**d.....** 100.000 Lekë. Anjetë Sipole 50%

**3.** Petraq Mufali, ditë 1968, lindur e  
Leunes Hajdunar, Elbasan.

**4. Statuti nënshkruar me datë** 17.2.87.

**5. Data** 27. II. 1987

**Statuti** 4 Fletë  
Kontrot 1 Hete  
**Njoftime:** a. shoqëria

**b. dhomën e tregtisë**


**c. organin përkatës tatimor**

**d. zyrën e statistikës**

**Publikime:**

M. Arkëtigimi m. 021272  
dit. 11. Shkurt 87.  
BPK Elbasan.

**G J Y Q T A R E**

Manjane Deoli  


AKTI : THEMELIMIT  
TE SHOQERISE " MUFALI " SH.P.K

Ne baze te ligjit nr.7512 date 10.8.1991, te ligjit nr.7638 date 19.11.1992, te ligjit nr.7667 date 28.1.1993(neni 64) me vullnetin tone te lire te shprehur ne nenshkrimin e ketij akti ortaket:

Petraq Mufali i biri i Jorgjit, lindur me 1968 ne fshatin Hajdaran te Elbasanit, dhe banues ne fshatin Hajdaran te Elbasanit.

Elbasanit dhe banues ne fshatin Hajdaran te Elbasanit,  
Andrea Shqau i biri i Agimit, lindur me 1974 ne fshatin Mlize te Elbasanit  
nit dhe banues ne fshatin Mlize te Elbasanit,  
Kemi krijuar shoqerine me per gjegjesi te kufizuar "MUFALI" sh.p.k.

## OBJEKTI I SHOQERISE

OBJEKTI I SHOQERISE

Objekti i shoqerise me perjegjesi te kufizuar "MUFALI" sh.p.k eshte:  
"-Shfrytezimi dhe perpunimi i lendet drusore, prodhim dhe tregtim te elementeve prej druri, te mobiljeve, prodhim dhe tregtim me shumice dhe pakice te materialeve prej druri per ndertim, prodhim dhe tregtim te drurit si lende  
djegese etj, -Tregtim te mallrave te ndryshem industriale dhe ushqimore, bujtuesore dhe blegtorale, i bimeve medicinale, lendeve te ndertimit. Tregtim te plehrave kimike dhe kimikateve te ndryshme; tregtim me shumice dhe pakice. Importe dhe Eksportet."

## SETTA E SHOQEIRISE

Selia ashtë në fshatin Mlize te rrëthit te Elbasanit.

KOHESZGJATJA

KOHEZGJATJA  
Shoqeria do te kete një aktivitet mbi dhjete vjet dhe mund te shper-  
behet në cdo kohe.

## KAPITALI THEMFLOR DHE KUOTAT

Kapitali themeltar i shoqerise "MUFALI" sh.p.k eshte 100.000 leke. Asamblea e ortakeve eshte organi me i larte i shoqerise me perjegjesi te kufizuar "MUFALI" sh.p.k. Administrator i shoqerise do te jetë Petraq Mufali.

Kapitali i shoqerise eshte i formuar nga ortaket ne menyre te barabarte me nga 50% secili, ose i shprehur ne kuote me nga 50 kuota secili ortak.

OPTAKIT E SHOQERTISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "MUFALI"

~~DEBRA~~ MUFALT

— 11 —

REPUBLIKA SHQIPERISE  
DUOMA NOTERREVE ET-BASAN

Elbogen ms 17.02.1997

Nr. Rep. 1576

V E R T E T I M

Ne Elbasan sot me date 17.02.1997 ne zyren e noterise, para meje no  
res Majlinda Lato u paraqiten personalisht z. Petraq Mufali i biri i Jorgj  
lindur me 1968 ne Hajdaran te Elbasanit dhe banues ne Hajdaran te Elbasan  
dhe z. Andreea Shqau i biri i Agimit, lindur me 1974 ne fshatin Mlize te Elb

STATUTI I SHOQERISE MR PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"M U F A L I" SH.P.K

E M E R T I M I

NENI 1

Formohet shoqeria me emerin "MUFALI" me pergjegjesi te kufizuar, e themeluar nga ortaketet Petraq Mufali i biri i Jorgjit, lindur e banues ne fshatin Hëjdaran te Elbasanit dhe z. Andrea Shqau i biri i Agimit, lindur e banues ne fshatin Mlize te Elbasanit.

S E L I A S H O Q E R I S E

NENI 2

Selia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "MUFALI" eshte ne fshatin Mlize te rrethit te Elbasanit.

O B J E K T I I V EPRIMTARISE

NENI 3

Objekti i veprimtarise se shoqerise "MUFALI" sh.p.k eshte :

"-Shfrytezimi dhe perpunimi i lendet drusore, prodhim dhe tregtim te elementeve prej druri, te mobiljeve, prodhim dhe tregtim me shumice dhe pakice te materialev te prej druri per ndertim, prodhim dhe tregtim te lendet drusore si lende djegese etj.-Tregtim te mallrave te ndryshem industriale dhe ushqimore, bujqesore dhe blektorale, i bimeve medicinale, lendeve te ndertimit, tregtim te plehrave kimike dhe kimikateve te ndryshme, tregtim me shumice dhe pakice. Importe dhe Eksporte.

K O H E Z G J A T J A

NENI 4

Jete gjatesia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar MUFALI sh.p.k eshtet mbi dhjete vjet. Ajò mund te shperndahet perpara ketij afati me vendim unanim te asamblese se ortakeve, ose kur verifikohen rrethana te tilli kur shperndarja e saj urdherohet nga he menyre te prere nga ligji.

KAPITALI THEMELTAR DHE KUOTAT OSE PJESET

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqerise "MUFALI" sh.p.k eshte 100.000 leke indare ne kuota te barabarta midis ortakeve me nga 50 kuota secili ose me nga 50% secili nga ortaketet.

NENI 6

Ndryshimi i mases se kapitalit themeltar si per shtimin apo per pakesimin e tij behet me vendim te asamblese se ortakeve me unanimitet.

NENI 7

Kuotat ose pjeset jane nonimative dhe lirisht te transferueshme midis ortakeve. Transferimi i tyre behet vetem me akt notarial dhe cdo transferim i tyre tek te tretet i nenshkrohen te drejtes se parablerjes nga ortakut

NENI 8

Kuotat e pjesemarjes ne kapital jane te gjitha te emertuara dhe te pandahshme, do kuote i takon e drejta e nje vote.

ASAMBLEJA E ORTAKEVE NENI 9

Asambleja e ortakeve eshte organi me i larte i shoqerise me perpjegjesi te kufizuar "MUFALI". Vendimet e saj ne perputhje me ligjin dhe normat e ketij statuti jane te detyrushme per te dy ortaket duke perjashtuar te drejtene e tyre te ankimit kunder veprimeve qe ata i cmojne te demshme per interesat e tyre.

NENI 10

Organ vendimor i shoqerise eshte asambleja e ortakeve. Asambleja e ortakeve zgjedh keshillin administrativ. Keshilli administrativ zgjedh administratoret qe do ta perfakesojne ne marredhenie me te tretet shoqerine. Asambleja mblidhet ne mbledhjen e saj te zakonshme dhe te jashtezakonshme. Administrator i shoqerise do te jetet z. Petraq Mufali.

Ne mbledhjet e zakonshme ajo shqyrton dhe vendos per ceshtje te tillasi: emerim apo shkarkim i administratorit, ekspertereve dhe kontablisteve te autorizuar dhe likujduesve, miratimin e raporteve te administrimit dhe kontrollit, miratimin e llogarive vjetore, ndarjen e fitimit etj.

Ne mbledhjet e jashtezakonshme asambleja e ortakeve vendos per ceshtje te tilli si ndryshimet e statutit, zvogelimin e kapitalit tjemeltar tek te tretet, zgjatja e kohes se veprimtarise se shoqerise apo likujdimi i saj.

NENI 11

Shoqeria "Mufali" sh.p.k vepron ne regjimin e pronesa private dhe merr persiper vete te drejta e detyrimi. Ajo perpjigjet vete per detyrimet e saj kontraktore dhe jashte kontraktore brenda kapitalit te saj.

Ortaket bartin rrezikun per veprimtarine e shoqerise ne nivelin e shumes se mjeteve te kapitalit te investuar ne rastin e krijimit te shoqerise. Ortaket nuk perpjigjen me pasurine e tyre vetjake per detyrimet e shoqerise, te cilen e kane realizuar me veprimtarine e tyre me persona te tretet.

NENI 12

Shoqeria drejtohet nga nje ose disa administratorore qe duhet te jen ne persona juridike si dhe mind te jene ortake ne shoqeri ose jo. Ata kane mundesi te kryejne te gjitha aktet qe konsiderojne te nevojsjhem per arritje e qellimeve te shoqerise, ata kane te drejta midis te tjerave te blejne dhe te kembejne pasuri, te lidhen me shoqeri te tjera te ngritura ose qe do te krijoen si brenda ashtu edhe jashte shtetit, duke siguruar pjesemarrjen per qellimet e veprimtarise ekonomike. Emertimi i nje administratori beket per nje kohezgjatje prej tre vjetesh financiar, me perjashtimin e rasteve te dreheqjes ose te shkarkimit te parakohshem.

Ne marredheniet me ortaket ose me te tretet administratorot kane te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet e administratorit te shoqerise e ne emer te saj.

Administratorët janë pergjegjes ndaj shoqerise ose ndaj e treteve qofte per shkelje ligjore, qofte per shkelje të statutit ose per faje të kryere gjatë administrimit.

NENI 13

Ne rast hevoje ose kur e kerkon ligji kontrolli i shoqerise kryhet nga një ekspert kontabel i autorizuar nga ortaketë e shoqerise. Ne rast se vërehen gabime ose behet e pamundur kryerja e detyres nga eksperti kontabel ky i fundit mund te shkarkohet, shkarkimi i te cilit vendoset me te njejtë menyre si dhe emerimi i tij.

NENI 14

Te gjithe te punesuarit ne shoqeri janë te detyruar te ruajne sekretin e punes se shoqerise duke e vazhduar kete detyre edhe pes largimit te tyre nga shoqeria.

SHPERNDARJA E SHOQERISE

NENI 15

Shperberja e shoqerise mund te vije ne cdo kohe dhe per cfaredo shku si per humbje te kapitalit te shoqerise, pamundesi veprimtarie ose me vendim te asamblese se ortakeve. Ne kete rast ata vendosim mbi menyrat e likujdimit dhe caktojne një ose me shume likujdatore duke i perkaktuar detyrat. Keta kujdesen qe ne rradhe te pare te shlyhen detyrimet qe shoqeria u ka personave te trete.

NENI 16

Per sa me siper nuk eshte shprehur ne kete statut i referohet plotesi meve qe do te bese asambleja e ortakeve si dhe ligjeve te vecanta te legjisacionit shqiptar. Ndryshimet dhe plotesimet e ketij statuti behen ne te njejten menyre dhe procedure me te cilen nxirret dhe statuti.

NENI 17

Te gjitha kundershtimet eventuale midis ortakeve te shoqerise zgjidhen nga një kolegj arbitrar perj tre vetash ku secili nga palet caktor ne nga një arbiter dhe i treti zgjidhet nga dy te paret ose kryetari i gjykatës se rrëthit. Arbitrat kerkojne zgjidhjen me mirekuptim dhe vendimet e tyre do te pranohen nga pjesetaret ne komflikt si shprehje e vete vullnetit te tyre. Vendimet merren ne vendin dhe ne kohen e parashikuar nga asambleja e ortakeve.

NENI 18

Vendimet e kolegjit arbitrar mund te apelohen vetem nese nga palet kerkon arbitrazhe te metejshem prane gjykates se rrëthit Tirane ku eshte depozituar ky statut.

NENI 19

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen me kontraten e punes Per cseshtjet qe nuk rregullohen me kontraten e punes zbatohen dispozitat e legjisacionit shqiptar te punes. Kjo eshte e njejte edhe per filialat zyrat e perfajesise ose agjensite e tjera te shoqerise.

NENI 20

Shoqeria mund te hape filjale te tjera, perfagesi apo agjensi ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

NENI 21

Per te saktesuar veprimtarine e veteconomike dhe marredheniet e pune se ne shoqeri, shoqeria do te cele librin e vete i cili do te quhet "libri i shoqerise Mufaki sh.p.k".

NENI 21

Bilanci i shoqerise mbylljet me 31 dhjetor te cdo viti.  
Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore te shoqerise behet brenda nje afati prej gjashte muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

ORTAKET E SHOQERISE "M U F A L I " SH.P.K

PETRAQ MUFALI

ANDREA SHQAU

REPUBLIKA SHQIPERISE  
DHOMA NOTEREVE ELBASAN

Nr. 1576 rep.

Elbasan me 17.02.1997

#### V E R T E T I M

Ne Elbasan sot me date 17.02.1997 ne zyren e noterise, para meje notres Majlinda Lato u paraqiten personalisht z.Petraq Mufali i biri i Jorgjit, lindur me 1968 ne fshatin Hajdaran te Elbasenit dhe banues ne Hajdaran te Elbasenit dhe z.Andrea Shqau i biri i Agimit, lindur me 1974 ne fshatin Mlize te Elbasenit dhe banues ne fshatin Mlize te Elbasenit, qe te dy madhere dhe te afte per te kryer veprime juridike, te njohur nga une noteria ne baze te letrenjoftimeve qe me paraqiten te cilet deklaruan se sa me siper eshte hartuar konform vullnetit te tyre dhe me doren e tyre dhe me vullnet te lire e nenshkruan ne pranine time noteres.

Ne fund u vertetua dhe ng a une noteria.

N O T E R E

MAJLINDA LATO



17083/1

K E R K E S E

K E R K U E S : PETRAQ MUFALI i biri i Jorgjit, lindur me 1968 ne fshat Hajdaban te rrerhit te Elbasanit dhe banues ne Hajdaran te Elbasanit.

O B J E K T I: Depozitim prane rregjistrat Tregtar te Gjykates se Rrerhit Gjyqasor Tirane tek Vendimit te Asamblese se Ortakeve te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "MUFALI" (sh.p.k.) per kalimin e shoqerise ne një ortaku te vetem.

G J Y K A T E S   S E   R R E T H I T

Llojtore - Shqip

T I R A N E

Nr. 387/76

dt. 27.11.1997

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "Mufali" sh.p.k eshte rregjis  
truar si person juridik me vendimin me <sup>nr. 17083</sup> date <sup>27.11.1997</sup>.

Shoqeria "Mufali" sh.p.k. eshte rregjistruar ne rregjistrat tregtar  
te shoqerive me dy ortake dhe me administrator te shoqerise z.Petraq  
Mufali.

Me vendimin e Asamblese se Ortakeve te shoqerise "Mufali" sh.p.k  
nr.1 date 14.1.2000 eshte vendosur shitja e aksioneve te ortakut Andrea  
Shqau ortekut tjeter te shoqerise z.Petraq Mufali dhe kthimi i shoqerise  
se Mufali sh.p.k me ortak dhe administrator te vetem te saj z.Petraq  
Mufali.

Per sa ne siper kerkoj nga Gjykata depozitimin e vendimit te Asamble  
se se Ortakeve.

Kesaj kerkese i bashkengjitet vandimi i asamblese se ortakeve nr.1  
date 14.1.2000 dhe kontrata e shitjes e aksioneve.

K E R K U E S

PETRAQ            MUFALI

REPUBLIKA SHQIPERISE  
DHOMA NOTERIVE ELBASAN  
NR. 327 rep.  
N r. 78 kol.

Elbasan me 15.01.2000



KONTRATE SHITJE

Ne Elbasan sot me date 15.01.2000 ne zyren time te ndodhur prane Gjykates se Rrethit Elbasan, para meje noteres Majlinda Lato u paraqiten personalisht palet kontraktuese, shtetas shqiptare:

Ne cilesine e shitesit z. ANDREA SHQUAU i biri i Agimit, lindur me 1975 ne fshatin Mlize te Elbasanit dhe banues ne Mlize te Elbasanit.

Ne cilesine e bleresit z. PETRAQ MUFALI i biri i Jorgjit, lindur me 1968 ne fshatin Hajdaren te Elbasanit dhe banues ne Hajdaran.

Qe te dy madhore dhe te afte per te kryer vepime juridike, te njojur nga uns noteria ne baze te dokumentave identifikues qe ne paraqiten te cilet ne kerkuan redaktimin e ketij akti si vijon:

Shitesi Andrea Shqau dha bleresi Petraq Mufali jene ortaku ne shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "MUFALI" sh.p.k me seli ne fshatin Mlize te Rrethit te Elbasanit, bazuar ne vendimin me nr. 17083 date 27.2.1997 te Gjykates se Tiranës. Shoqeris "Mufali" sh.p.k ka nje kapital themeltar prej 100.000 leke i formuar ne menyre te barabarte nga te dy ortaket duke zoteruar secili nga 50% (pesedhjete perqind).

Shitesi Andrea Shqau deklaron se 50% qe zoteron ne shoqerine "Mufali" sh.p.k, ose e shprehur ne kuota barabarte me 50 kuota, ja shet bleresit Petraq Mufali perkundrejt vlefte prej 50.000 (pesedhjetemije) leke te cilte shitesi deklaron se i ka marrë te gjitha ne dore nga bleresi jashtë kësaj zyre noteria.

Dhe bleresi Petraq Mufali eshte dakort qe te bleje pjesen prej 50% qe zoteron shitesi Andrea Shqau ne shoqerine "Mufali" sh.p.k perkundrejt vlefte prej 50.000 leke dhe deklaron se eshte likuiduar me shitesin per te gjithe shumen e shprehur ne kete kontrate jashtë kësaj zyre noteria.

Qe ne kete moment pronesia mbi 50% te kapitalit themelues dha qe perben 1/2 pjesa te shoqerise "Mufali" sh.p.k kalon nga shitesi Andrea Shqau tek bleresi Petraq Mufali e lire nga cdo pengesa ligjore duke u bere ky i fundit zoteruss i te gjithe kapitalit te shoqerise "Mufali" sh.p.k, me seli ne Mlize te Elbasanit, dhe ortak i vetem i shoqerise.

Mei sa me siper u redaktua ky akt ne tre kopje te njejtë origjinalë iu lexua paleve ne kontrate te cilet si e gjeten konform vullinstit te tyre e nenschruan me doren e tyre ne prenime time notares dhe se fundi u vertetus dhe nga uns noteria sipes ligjit.

Andrea SHQUAU

BLERESI  
Petraq MUFALI

NOTERJA  
MAJLINDA LATO

V E N D I M

I ASAMBLESË SE ORTAKEVE TE SHOQERISE "MUFALI" sh.p.k

Nr.1 Date 14.01.2000

Sot me date 14.01.2000 Asambleja e Ortakeve te shoqerise "MUFALI" Sh.p.k pasi diskutoi rrith shitjeve se aksioneve te shoqerise mbashtetur ne ligjin nr.7638 date 19.11.1992 dhe ne nenin 7 te statutit te shoqerise

V E N D O S I:

1-Pjesa e aksioneve te shoqerise "Mufali" sh.p.k prej 50% qe i perket ortakut te shoqerise z.Andrea Shqau t'i shitem ortskut te sjoqerise z.Petraq Mufali.

2-Shoqeria "Mufali" sh.p.k te mbetet me eftak te vetem dhe ne administrator te vetem Administrator i shoqerise mbetet z.Petraq Mufali.

3-Shoqeria "Mufali" sh.p.k do te ruaje emrin themelues te saj: Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "Mufali" sh.p.k.

4-Ky vendim i bashkengjitet statutit te shoqerise "Mufali" sh.p.k te miratuar nga gjykata kopetente.

5-Ky vendim te depozitohet ne Gjykaten e Rrethit Tirane i noterizuar.

6-Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

P/ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE "MUFALI" sh.p.k

ANDREA SHQAU

PETRAQ MUFALI

REPUBLIKA SHQIPERIA

DHOMA NOTERIVE ALBASAN

Nr. 386 rep.

Ellasan me 15.1.2000


V E R T E T I M

Ne Ellasan sot me date 15.1.2000 ne zyren time te ndodhur prane Gjykates se Rrethit Ellasan, para meje noteres Ajlinda Lete u paraqiten personalisht shtetasit shqiptare z.Andrea Shqau i kiri i Agimit,lindur ne 1974 ne Mlize te Ellasanit dhe bannes ne Mlize te Ellasanit dhe z.Petraq Mufali i kiri i Jorgjit,lindur ne 1968 ne Hajdaran dhe bannes ne Hajdaran te Ellasanit,qe te dy madhore dhe te afta per te kryer veprime juridike,te njojur nga une noteris ne baze te dokumentave identifikues

REPUBLIKA SHQIPERISE  
AVOKATIJA  
RPETHIT ELBASAN

Elbasan me 17.02.1997

K E R K.



MUFALI i biri i Jorgjiti, lindur me 1968 ne Hajdante Elbasanit dhe banues ne fshatin Hajdaran te Elbasanit.

ANDREA SHQUAU i biri i Agimit, lindur me 1974 ne fshatin Mlize te Elbasanit dhe banues ne Mlize te Elbasanit.

O B J E K T I : Kerkohje te miratohem i dhe te rregjistrohem i person juridik ne krijimin e shoqerise me perjegjesi te kufizuar "MUFALI" sh.p.k me qender ne fshatin Mlize te Elbasanit ne baze te ligjit 7512 date 10.8.1991, ligji 672 date 19.11.1992 dhe te ligjit 7667 date 18.1.1992.

P E R P A R A

GJYKATES SE RPETHIT

T I R A N E

Z! KRYETAR !

Paraqesim kerkesen per tu rregjistruar si person juridik ne krijimin e shoqerise me perjegjesi te kufizuar "MUFALI" sh.p.k.

Qendra e shoqerise eshte ne fshatin Mlize te rrerhit te Elbasanit me nje kapital themeltar prej 100.000 leke i formuar nga te dy ortaket secili, dhe ne kuota me nga 50 kuota secili ortak. Administrator i shoqrise "MUFALI" shpk do te jete z.Petraq Kufali.

Objekti i veprimtarise se shoqerise "MUFALI" sh.p.k do te jete: -Shfrytezimi dhe perpunimi i lendet drusore, prodhim dhe tregtim te elektrove prej druri, te mobiljeve, prodhim dhe tregtim me shumice dhe pakice materiale prej druri per ndertim. Prodhim dhe tregtim te drurit si leta materiale prej druri per ndertim. Prodhim dhe tregtim me shumice dhe pakice, Importe dhe Eksporte.

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte mbi dhjete vjet.

ORTAKET E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "MUFALI"

PETRAQ

MUFALI

ANDREA SHQUAU